

ANILA KANANAJ

VËSHTRIM I NJË GRAMATIKE LOGJIKE TË NJOHUR SHQIPTARE NË QASJEN GJENERATIVE

1.0. Hyrje

Qëllimi i këtij studimi është të shikojë dhe të vlerësojë nën dritën e qasjes gjenerative tiparet themelore të mendimit sintaksor të një gramatike logjike të njohur shqipe, konkretisht të *Sintaksa e gjuhës shqipe*, 1962, me autor Stefan Priftin.

Motivimi i këtij punimi vjen nga fakti që në traditën tonë gramatikore të viteve 1960-2000, gramatikat e shqipes të njohura si “gramatika logjike” janë kritikuar fort. Synimi ynë është të vështrohen edhe një herë tiparet themelore të tyre nën dritën e një qasjeje të re gjuhësore, për të parë nëse ato mbeten njësoj të kritikueshme apo një qasje tjetër gjuhësore ofron një tablo tjetër, konkretisht sipas qasjes gjenerative. Përfaqësuesi më i njohur i një gramatike të shqipes të hartuar në këndvështrimin logjik, është një punim i Stefan Priftit. Për këtë arsye vëmendja jonë do të ndalet pikërisht në veprën përfaqësuese të këtij autori, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, për ta parë atë edhe një herë nën dritën e qasjes gjenerative.

Punimi fillimisht do të nxjerrë në pah tiparet themelore më të kritikuar të veprës së marrë në shqyrtim. Gjatë evidentimit të secilit tipar të kritikuar, do të mundohemi të kuptojmë dhe të shpjegojmë se nga çfarë pozitash (sipas cilës qasje gjuhësore) janë bërë këto kritika dhe përse. Më tej, do të vlerësohet secili tipar themelor sintaksor në veprën e autorit sipas qasjes gjenerative. Në mbyllje të punimit do të jepen sugjerimet dhe përfundimet që dalin nga ky studim.

1.1. Tiparet themelore të kritikuar të veprës *Sintaksa e gjuhës shqipe* të S. Priftit

1.1.1. Logjicizmi: koncepti i kritikuar fort

Sintaksa e S. Priftit është kritikuar fort për logjicizëm. Çfarë do të thotë kjo?

Me logjicizëm kuptohet studimi i dukurive gjuhësore nga pozitë e disiplinës së logjikës, pra ta vështrosh dhe ta hulumtosh gjuhën sipas rregullave dhe parimeve të disiplinës së logjikës dhe jo sipas kriterëve të

mirëfillta gjuhësore. Sigurisht, në fillimet e gjuhësisë studimi i gjuhës nëpërmjet parimeve të disiplinës së logjikës ishte diçka normale, por nuk mund të pranohej më në shekullin XX, kur gjuhësia mori zhvillim të madh. Më konkretisht, në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, në krejt gjuhësinë bashkëkohore, gjuhëtarët u munduan të ndanin disiplinën e logjikës nga studimet gjuhësore. Ata donin që gjuha të studiohej sipas një këndvështrimi të pastër gjuhësor, duke e bërë kështu gjuhësinë një disiplinë të ndryshme nga disiplina e logjikës. Natyrisht, zhvillimet bashkëkohore u reflektuan edhe në gjuhësinë shqiptare të kohës përkatëse.

Ky është konteksti i zhvillimeve të drejtimeve gjuhësore në vendin tonë, në Evropë dhe në botë, që shoqëron kritikën që i është bërë S. Priftit. Por a është e bazuar një kritikë e tillë? Për t’iu përgjigjur kësaj pyetjeje, nevojitet të hulumtojmë konkretisht mendimin sintaksor të autorit.

Së pari, të shohim se si e trajton S. Prifti raportin sintaksë-logjikë.

Sipas autorit, “**Sintaksa** është ajo pjesë e gramatikës, që na mëson rregullat e bashkimit të fjalëve në fjali dhe të fjalivet në mes tyre, në pajtim me rregullat e përgjithshme të logjikës dhe me natyrën e veçantë të një gjuhe.”¹ (theksimi me shkronja të zeza – A. K.). A ka logjicizëm në këtë formulim të autorit, d.m.th. a ka gabim shkencor në këtë përkufizim? Le ta hetojmë më me kujdes atë. Në përkufizimin e S. Priftit, sintaksa:

- a) Është pjesë e gramatikës, ☒
- b) Studion lidhjen e fjalëve në fjali, ☒
- c) Studion lidhjen e fjalive me njëra-tjetrën, ☒
- d) Në përputhje me rregullat e përgjithshme të logjikës, ☒
- e) Si dhe në përputhje me natyrën e veçantë të një gjuhe. ☒

Pra, sintaksa për S. Priftin, studion rregullat e lidhjes së fjalëve në fjali dhe të lidhjes së fjalive me njëra-tjetrën në përputhje me rregullat e përgjithshme të logjikës, sepse fjalitë duhet të jenë të kuptimshme, dhe me rregullat specifike të një gjuhe, sepse secila gjuhë ka strukturën e vet specifike. Autori e vështron sintaksën si pjesë të gramatikës, pra si një nga modulet e gjuhës. Një qasje e tillë ndaj sintaksës është në përputhje me qasjen gjenerativiste, e cila përbën një drejtim gjuhësor mjaft të suksesshëm në ditët e sotme. Përfshirja e logjikës në këtë përkufizim, mund të jetë bërë shkas për ngritjen e kritikave. Por a mund të ketë realisht shkaputje të sintaksës nga logjika? Në përgjigje të kësaj, po sjellim një shembull klasik që citohet nga gjuhëtarët dhe studiuesit e gjuhës në mbarë botën:

¹ S. Prifti, *Sintaksa e gjuhës shqipe*, Prishtinë, 1971, f. 16.

“Colorless green ideas sleep furiously.”

(Idetë e gjelbra pa ngjyrë flenë furishëm.)

N. Chomsky, *Syntactic Structures*, 1957.

Kjo fjali ndjek rregullat e sintaksës së gjuhës angleze, që do të thotë se fjalët janë lidhur me njëra-tjetrën në fjali duke respektuar rregullat sintaksore të anglishtes. Konkretisht, rendi i përbërësve në fjali është në rregull: grupi i kryefjalës – folje – ndajfolje. Renditja e përbërësve brendapërbrenda grupit të kryefjalës, është gjithashtu në përputhje me rregullën e anglishtes për renditjen semantike të mbiemrave para një emri: 1) opinion (i bukur), 2) përmasë (i madh, i vogël), 3) formë (katrore, ovale), 4) moshë (i ri, i vjetër), 5) ngjyrë (i gjelbër, blu), 6) kombësi ose origjinë (anglez, spanjoll), 7) material (metal, pambuk) (*opinion, size, shape, age, colour, origin/nationality, material*). Renditja e përbërësve brenda grupit të kryefjalës e respekton këtë rregull. Eptimi i foljes është në përshtatje me grupin e kryefjalës: kryefjala në shumës – folja në shumës. E megjithatë, fjalia *“Colorless green ideas sleep furiously.”* është krejt pa kuptim edhe pse në aspektin gramatikor çdo gjë është në rregull. Kjo do të thotë se për të pasur fjali “normale” në një gjuhë të caktuar, nuk mjafton të respektohet rregullat gramatikore përkatëse të ndërtimit të një fjalie në atë gjuhë. Lidhjet e përshtatshme semantike midis përbërësve të fjalisë janë gjithashtu të domosdoshme. Gjuha dhe logjika mund të studiohen si dy disiplina të pavarura, por gjuha nuk mund të shkëputet nga logjika (në kuptimin që sapo e shpjeguam). Por si shprehet autori për këtë çështje? Citojmë:

“Sintaksa dhe logjika janë të lidhura ngushtë midis tyre, por ato nuk mund të identifikohen ashtu si vetë gjuha dhe mendimi, si forma e ndërtimit të mendimit me formën e ndërtimit të fjalisë.”²

Autori është i vetëdijshëm që sintaksa dhe logjika kanë lidhje të ngushtë midis tyre, por thekson gjithashtu që këto dy disiplina nuk mund të identifikohen.

Analiza jonë e deritanishme ka ecur në përputhje me qasjen gjenerative. Në këndvështrimin gjenerativ, autori ka dhënë një përkufizim të mirë shkencor për disiplinën e sintaksës.

Sidoqoftë, para se të arrijmë në një përfundim final, të shohim dhe disa tipare të tjera sintaksore të rëndësishme në *Sintaksën* e S. Priftit.

² Vep. cit., f. 15.

1.1.2. Mjetet e lidhjeve sintaksore

Për S. Priftin, mjetet e lidhjeve sintaksore janë:

- a) **fleksioni,**
- b) fjalët ndihmëse (parafjalët, lidhëzat),
- c) rendi i fjalëve,
- d) intonacioni.

Vështrimi i fleksionit si tipar sintaksor i fjalisë është veçanti që e dallon autorin në krejt traditën tonë sintaksore. Në punët sintaksore të dhjetëvjeçarëve pasardhës, gramatikanët e shqipes e kanë lënë në heshtje këtë tipar, i cili në gjuhësinë gjenerative përbën tipar sintaksor themelor të fjalisë. Struktura sintaksore e fjalës shihet prej tij si dukuri sintaksore. Ndërtimi gramatikor i fjalës nuk është vetëm një fakt i thjeshtë morfologjik, por edhe sintaksor. Fleksioni, rasa, numri, gjinia janë nocione sintaksore. Ato kanë lindur nga nevoja e domosdoshme e fjalëve për t'u bashkuar me njëra-tjetrën në fjali. Kategoritë e fjalëve (klasat e fjalëve) në gjuhësinë moderne përbëjnë një kapitull të rëndësishëm në sintaksë, qasje e cila duhet të pasqyrohet edhe në gjuhësinë tonë.

1.1.3. Fjalja, kryefjala, kallëzuesi si nocione themelore në Sintaksën e S. Priftit

Për autorin, njësia themelore e sintaksës është fjalja, kryefjala është gjymtyra kryesore, gramatikisht e pavarur. Kallëzuesi është gjithashtu gjymtyrë kryesore e fjalisë, por gramatikisht varet nga kryefjala. Të gjitha gjymtyrët e dyta quhen ndryshe edhe plotësorë (plotës).

Sa i takon kallëzuesit, sipas S. Priftit, ai gramatikisht varet nga kryefjala për arsye se shpreh atë çka i pohohet ose i mohohet kryefjalës. Ai shihet si gjymtyrë predikative dhe në procesin e komunikimit konsiderohet pjesë kryesore e fjalisë. Sipas autorit, morfologjikisht, kallëzuesi mund të shprehet me një folje të çdo forme e diateze, me një mbiemër, emër, përemër, numëror a ndajfolje në rastin e kallëzuesit emëror ose me një fjali. Kallëzuesi foljor mund të jetë i shtjelluar ose i pashtjelluar. Kallëzuesi foljor i pashtjelluar mund të shprehet me paskajore (në fjali të varur e të pavarur), përcjellore dhe pjesore, pohon autori. Shembujt e autorit për këtë çështje janë të gjithë me paskajore “gege”. Paskajorja me “për të” trajtohet si paskajore e dytë. Si kallëzues foljor i pashtjelluar mund të merret edhe emri foljor asnjans, i cili shpesh ka dhe kundrinë të drejtë.

Me përjashtim të asaj që kallëzuesi shihet i varur gramatikisht nga kryefjala (në sintaksën bashkëkohore kallëzuesi shihet në përshtatje me

kryefjalën, jo i varur prej saj), pjesa tjetër e konceptimit të kallëzuesit nga S. Prifti është mjaft bashkëkohore dhe ende nuk është kapërcyer në gramatikat tona. Trajtimi i foljeve të pashtjelluara si kallëzues foljorë të pashtjelluar është përputhje me qasjen gjenerativiste. Është me interes për studimet tona trajtimi i emrave foljorë asnjans si kallëzues foljorë të pashtjelluar. Kjo çështje meriton të hetohet më tej nga gjuhëtarët. Gjithashtu, paraqet interes për t'u parë më gjerë, trajtimi që u bën autori funksioneve të kallëzuesit të realizuar me paskajore në toskërishte dhe në gegërishte.

1.1.4. Opozicioni kryesor në fjali

Sipas S. Priftit, opozicioni kryesor në fjali është *njësi predikative – njësi jopredikative*. Autori e sheh njësinë predikative në kuptimin e gjerë dhe në kuptimin e ngushtë. Në kuptimin e gjerë njësi predikative është fjalia e thjeshtë me një folje të shtjelluar ose të pashtjelluar. Në kuptimin e ngushtë, njësi predikative është kallëzuesi, plotësori predikativ / kallëzuesor. Shikimi i fjalisë në opozicionin *njësi predikative – njësi jopredikative* është tipar i sintaksës moderne. Ky kriter duhet hulumtuar më tej për të parë se çfarë rezultatesh sjell aplikimi i saj në teorinë sintaksore të shqipes.

1.1.5. Plotësori predikativ i një gjymtyre të dytë

Si plotësorë predikativë të një gjymtyre të dytë, autori dallon mbiemrat preppjesorë të theksuar me të zezë në shembujt e marrë prej tij:

të shoh me buzë të plasur, me fytyrë të tmerruar, me kokë të varur, me sy të zgurdulluar, me fytyrë të qeshur.

Funksioni sintaksor i mbiemrit preppjesor në fjali është një çështje ende e pazgjidhur në sintaksën tonë. Bashkohemi me mendimin e autorit që mbiemri preppjesor në konstruktet më lart ka funksion predikativ. Mbetet për t'u diskutuar nëse është plotës apo përbërës i një niveli tjetër.

Për S. Priftin, emri e mbiemri me kuptim foljor të një veprimi tranzitiv që marrin kundrinë të drejtë, janë njësi sintaksore jopredikative. Këtu autori distancohet mjaft prej logjikës, pasi në aspektin logjik (në aspektin psikologjik me termat e Menella Totonit), emri e mbiemri foljor shërbejnë si predikatë. Ky koncept i autorit mban vulën e kohës përkatëse, pasi në sintaksën moderne emri e mbiemri foljor trajtohen si njësi predikative.

1.2. Metodologjia e punës së autorit

Metodologjia e punës e autorit plotëson kërkesat e shkencës gjuhësore bashkëkohore. Vepra *Sintaksa e gjuhës shqipe* (1971) e S. Priftit është sintaksë e gjuhës shqipe, jo thjesht sintaksë e gjuhës standarde. Kjo dëshmohet nga shembujt e përzgjedhur me kujdes nga të dy dialektet kryesore të shqipes. Shembujt ilustrues janë gjetur nga letërsia e shkruar, “goja e përditëshme e popullit” dhe media e shkruar dhe e folur. Kjo përbën një vlerë shumë të madhe të punës së autorit dhe një sfidë që mbetet ende për t’u realizuar nga gramatikanët shqiptarë.

1.3. Si shpjegohen kritikak

Ky studim dëshmoi se S. Prifti ka zbatuar kriteret shkencore dhe metodologjikë pune bashkëkohore në veprën e vet. Një pjesë e mirë e këtyre kriterëve mbeten ende sfidë për gjuhësinë shqiptare. Atëherë si mund të shpjegohen kritikak?

Gjysma e dytë e shekullit të kaluar karakterizohet nga sundimi i strukturalizmit në Evropë. Në Rusi strukturalizmi u gërshetua me tipare të materializmit dialektik. Duke pasur parasysh kontekstin historik të Shqipërisë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar, është e natyrshme që në studimet sintaksore shqiptare të ndjehen ndikime të forta dhe të ndiqet modeli i gjuhësisë ruse³. Ky kontekst shpjegon kritikak që i janë bërë *Sintaksës* së S. Priftit. Për më tepër, gjëja për të cilën u kritikua fort drejtimi strukturalist, dhe, nuk mund të mohohet, edhe gjenerativizmi në fillimet e veta, ishte lënia mënjanë e anës semantike, duke u përqendruar kryesisht në strukturën e fjalisë. Sidoqoftë, gjenerativizmi e mbushi këtë boshllëk. Ndërkaq, nuk mund të thuhet e njëjta gjë për strukturalizmin.

Diskutime dhe sugjerime

Një çështje që del për diskutim nga vepra e autorit, është nëse duhet të përdoret ende në gjuhësinë tonë dhe në tekstet tona shkollore termi *gjymtyrë*. Sigurisht, është i kuptueshëm përdorimi i këtij termi në kohën e S. Priftit, por a duhet të përdoret ende në tekstet tona shkollore?

Termi *gjymtyrë* i referohet një njësie gjuhësore që kryen një funksion sintaksor në fjalinë e thjeshtë. Ndarja në gjymtyrë kryesore (të para) dhe në gjymtyrë të dyta (të varura) ka të bëjë me hierarkinë e përbërësve

³ A. Kananaj (2014), *Ndikime të ideologjisë në studimet sintaksore të shqipes*. Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”. Sesioni shkencor i gjuhësisë “Gjuha shqipe dhe ideologjia”. Universiteti i Prishtinës, 29 gusht.

sintaksorë brenda strukturës së fjalisë. “Gjymtyra e dytë” në strukturën e varësisë jo domosdoshmërisht është e dyta për nga rendi në lidhje me fjalën që plotëson, siç është rasti i një përcaktori a rrethanori që varet nga një përcaktor, kundrinor, kryefjalë etj. *Gjymtyrë e dytë* do të thotë realisht *gjymtyrë e varur*.

Në qasjet gjuhësore bashkëkohore, kjo lloj terminologjie nuk ekziston më. Jemi të mendimit se edhe në gjuhësinë tonë duhen përditësuar qasjet dhe termat gjuhësorë.

Përfundime

Ky studim dëshmoi se S. Prifti ka zbatuar kritere shkencore dhe metodologji pune bashkëkohore në veprën e vet. Një pjesë e mirë e këtyre kritereve mbeten ende sfidë për gjuhësinë shqiptare.

Kritikat që i janë bërë veprës së autorit janë të kuptueshme vetëm në kontekstin historiko-gjuhësor të Shqipërisë në gjysmën e dytë të shekullit të kaluar. Theksojmë se tiparet themelore të *Sintaksës* “logjike” të S. Priftit, veçanërisht ato që janë trajtuar si të meta të saj, në qasjen gjenerative përbëjnë tipare thelbësore karakterizuese dhe vlera.

BIBLIOGRAFI

- Agalliu, F. (1988), *Çështje të morfologjisë së gjuhës së sotme shqipe*. Universiteti Shtetëror i Tiranës, Tiranë: Shtypshkronja “Mihal Duri”.
- Buxheli, L. (2007), *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*. Akademia e Shkencave e Shqipërisë. Instituti i Gjuhësisë dhe i Letërsisë, Tiranë: Neraida.
- Buxheli, L. (2011), *Foljet njëvetore në gjuhën shqipe*. Tiranë: Qendra e Studimeve Albanologjike, Botimet Albanologjike.
- Carnie, A. (2006), *Syntax: A Generative Introduction*. Second edition. Oxford: Wiley Blackwell Publishers.
- Chomsky, N. (1995), *The Minimalist Program*. Cambridge, London: The MIT Press.
- Chomsky, N. (1981), *Lectures on government and binding: the Pisa lectures*. Holland: Foris Publications.
- Çeliku, M.; Domi, M.; Floqi, S.; Mansaku, S.; Përnaska, R.; Prifti, S. & Totoni, M. (1997), *Gramatika e Gjuhës shqipe: Vëllimi II Sintaksa*. Tiranë: Akademia e Shkencave e Shqipërisë.
- Haegeman, L. (1994), *Introduction to Government and Binding Theory*. Oxford UK & Cambridge USA: Blackwell.

- Kananaj, A. (2014), *Ndikime të ideologjisë në studimet sintaksore të shqipes*. Seminari XXXIII Ndërkombëtar për Gjuhën, Letërsinë dhe Kulturën Shqiptare”. Sesiioni shkencor i gjuhësisë “Gjuha shqipe dhe ideologjia”. Universiteti i Prishtinës, 29 gusht, Prishtinë.
- Memushaj, R. (2008), *Gjuhësia Gjenerative*. Botim i dytë i përmirësuar. Tiranë: SHBLU.
- Memushaj, R. (2008), *Gjuhësia Gjenerative*. Botim i dytë i përmirësuar. Tiranë: SHBLU.
- Mita, J. (2005), *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*. Prishtinë: Shpresa.
- Mita, J. (2005), *Hyrje në sintaksën gjenerative të shqipes*. Prishtinë: Shpresa.
- Prifti, S. (1986), *Problemi i klasifikimit të gjymtyrëve të dyta të fjalisë*, “Studime për nder të Aleksandër Xhuvanit”. Tiranë, f. 333-344.
- Prifti, S., *Sintaksa shqipe*. Tiranë, USHT, Fakulteti Histori-Filologji. Ribotim në Prishtinë më 1971.
- Rushi, Th. (1987), *Disa çështje të gjymtyrëve të dyta të fjalisë në gjuhën shqipe*. “Studime filologjike”, nr. 3, f. 123-129.
- Rrota, J. (1944), *Sintaksa e gjuhës shqipe*. Botim i dytë. Shkodër: Shtëpia botuese “A. Gj. Fishta”.
- Rrota, J. (2006), *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*. Shkodër: Botime Françeskane.
- Rrota, J. (2006), *Sintaksa*. Në: *Gjuha e shkrueme ase vërejtje gramatikore*. Shkodër: Botime Françeskane.
- Spenser, A. (1997), *Morphological Theory: An Introduction to Word Structure in Generative Grammar*. Oxford UK & Cambridge USA: Blackwell.
- Sheperi, I. (1927), *Gramatika dhe sintaksa e gjuhës shqipe*. Tiranë.
- Totoni, M. (1981), *Çështje të gjymtyrëve të fjalisë*. “Studime filologjike”, nr. 3, f. 109-115.